

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Përshkallëzohen tensionet në Ceuta: Mijëra emigrantë në pritje për një vend në kampin e ri
ADRESA	https://tpz.al/pershkallezohen-tensionet-ne-ceuta-mijera-emigrante-ne-pritje-per-nje-vend-ne-kampin-e-ri-i333271
BURIMI	tpz.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 14:50:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 14:41:44 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ddb97309639ea5804f0fb15e674e773df872d17af358e631469cc4d7df0dda7e
TEKSTI	21db1b50fce26d3d68186600cf3e1ae0742a417242f9731d116b0d5a1ed22057
PAMJA	60e904d9990ce69af01d5d88c310afcb5f46787a6f9857a94af2d1a7b5cb20b2

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	76320f5ac5624c8beb016075d8509df12bfa14a8b6b8f1a0049e1bfea88d384f
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565145c81569d96b39079f1db9ed9e378c0d0ec132a26687d139f465bf7be21b
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/76320f5ac5624c8beb016075d8509df12bfa14a8b6b8f1a0049e1bfea88d384f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FLASH!

13:50 VIDEO/ Tentoi të korruptojë policin me 2 mijë lekë, pasi u kap i dehur në timon, merret nën hetim shoferi në Tiranë! • 13:44 Nisma e re, prona e konfiskuar në rrethina

BOTA, 18 SEPTEMBER 2026, 16:41

Përshkallëzohen tensionet në Ceuta: Mijëra emigrantë në pritje për një vend në kampin e ri

tpz.al TPZ



Skena tensioni janë regjistruar të premten në rrugët e Ceutës, në Spanjë, ku mijëra emigrantë u nisën masivisht drejt një strehimi të ri të ngritur pranë portit. Autoritetet spanjolle kishin nisur një operacion për transferimin e emigrantëve që prej javësh jetonin në kushte të vështira në plazhe dhe strehimore të improvizuara. Por procesi u shoqërua me kaos, pasi një numër i madh njerëzish nxituan drejt kampit të ri për të siguruar një vend.

Operacioni nisi rreth orës 06:30 sipas kohës lokale. Sipas një burimi qeveritar spanjoll në Ceuta, policia ndërhyri për të kontrolluar situatën, ndërsa mediat lokale raportuan për angazhimin e Policisë Kombëtare dhe njësisë të kontrollit të trazirave. Ka gjithashtu raportime për përdorimin e gazit lotsjellës. Videot e publikuara nga vendngjarja tregojnë turma të mëdha emigrantësh që vrapojnë nëpër rrugët e qytetit. Shumë prej tyre shfaqen duke bërë turrë dhe festuar ndërsa drejtohen për në akomodimin e ri.

Kampi i ngritur pranë portit ka një kapacitet prej rreth 1,700 personash dhe është pajisur me tenda, shtretër dhe dushe. Qeveria spanjolle vendosi të vijojë transferimin pavarësisht kundërshtimit të shprehur nga autoritetet lokale. Situata në enklavën spanjolle në Afrikën e Veriut filloi të përkeqësohej në fund të korrikut, kur dhjetëra mijëra emigrantë kaluan nga Maroku drejt Ceutës.

Shumica e tyre janë kthyer, por sipas autoriteteve lokale, rreth 13 mijë persona mbeten ende në zonë. Shumë prej tyre janë detyruar të jetojnë në strehimore të improvizuara dhe në plazhe. Kryeministri spanjoll, Pedro Sanchez, është përballur me kritika për mënyrën se si qeveria e ka trajtuar situatën. Ai i ka hedhur poshtë akuzat për keqmenaxhim, duke argumentuar se shërbimet përkatëse u përballën me një numër mbërritjesh që nuk mund ta përballonin.

Në një paraqitje televizive më 14 shtator, Sanchez pranoi se autoritetet ishin të mbingarkuara nga numri i emigrantëve që mbërritën në Ceuta. Ai tha se synimi i qeverisë është që situata të jetë nën kontroll deri në fund të vitit, duke kërkuar durim nga rreth 84 mijë banorët e qytetit. Ndërkohë, janë ngritur pikëpyetje edhe për faktin nëse qeveria spanjolle ishte informuar paraprakisht për mbërritjet masive.

ide!

Vendimi i Hagës si moment reflektimi
Nga Ergys Mërtiri

Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?
Nga Andi Bushati

Teje e Këtej

Tronditet Edi Rama, i kërkohet largimi urgjent nga zyra brenda shtatë ditëve (letra)

Denonco!

Ke një lajm që do ta ndash me redaksinë e TPZ? Na shkruaj në Messenger ose [kliko këtu](#) për mënyra të tjera kontakti.



Moti

Tirana, Albania

WebTV



Ka frikë nga hetimet guvernatori?/ Ola Xama tregon pse i duhet super imuniteti Gent Sejkos

[Shiko të tjera video](#)

Fillimisht, autoritetet spanjolle deklaruan se nuk kishte pasur paralajmërim për atë që do të ndodhte. Por më vonë qeveria publikoi 40 komunikime të klasifikuara më parë, të cilat tregonin se Qendra Kombëtare e Inteligjencës e Spanjës (CNI) kishte raportuar më 29 korrik për përpjekje të organizuara për të hyrë në Ceuta nga toka dhe deti. Një prej komunikimeve i referohej një thirrjeje në rrjetet sociale për një kalim masiv mbrëmjen pasuese. Sipas Daily Mail, CNI ia kishte përcjellë gjithashtu informacionin shërbimeve të inteligjencës marokene.

Sanchez ka kundërshtuar interpretimin se këto komunikime përbënin një paralajmërim zyrtar për përmasat e asaj që ndodhi. Përveç situatës së strehimit, banorët e Ceutës kanë shprehur shqetësime për sigurinë. Sipas raportimeve të mediave britanike, në zonë janë regjistruar incidente të përditshme dhune, sulme ndaj ushtarëve dhe dhjetëra sulme seksuale.

Prokurorja e Ceutës, Silvia Rojas, ka folur për një "rritje eksponenciale" të krimeve, duke përmendur edhe raste të sulmeve seksuale dhe incidente që përfshijnë të mitur. Ekspertë të sigurisë publike kanë paralajmëruar gjithashtu për rrezikun e përshkallëzimit të mëtejshëm të tensioneve. Kushtet sanitare në kampet e improvizuara janë një tjetër shqetësim. Një adoleshent nga Maroku është diagnostikuar këtë javë me linë e majmunëve dhe është vendosur në izolim, ku po merr trajtim. Ndërkohë, të paktën pesë raste të tuberkulozit janë raportuar mes emigrantëve.

Presidenti rajonal i Ceutës, Juan Jesús Vivas, ka kërkuar më shumë mbështetje nga Bashkimi Evropian, duke e krahasuar situatën në qytet me një "tenxhere me presion" që mund të shpërthejë në çdo moment. "Qyteti është krejtësisht i ndryshëm nga ai që ishte para kësaj ngjarjeje. Njerëzit e Ceutës e kanë humbur gëzimin dhe mënyra e tyre e jetesës është tronditur plotësisht", u tha Vivas eurodeputetëve.

BOTA / 18 September 2026, 15:50

I dërguari amerikan: SHBA-ja po "shkon në drejtimin e duhur" me Bjellorusin

BOTA / 18 September 2026, 15:27

Zgjedhjet në Gjermani vënë në provë Merz, tronditet ekuilibri politik

BOTA / 18 September 2026, 14:39

Rusët votojnë në zgjedhjet e para parlamentare që nga nisja e pushtimit të Ukrainës më 2022

BOTA / 18 September 2026, 13:02

Lufta/ "Gjithçka mund të ndodhë", Trump paralajmëron vendim të rëndësishëm, Irani vijon sulmet ndaj anijeve në Hormuz

BOTA / 18 September 2026, 12:44

FOTOT/ Për herë të parë pas 100 vitesh, zbulohet një specie e re maceje në pyjet boliviane

BOTA / 18 September 2026, 11:19

"Super-aplikacioni" i Rusisë, si e përdori "Max" për të spiunuar qytetarët! Skema dhe taktikat e përdorura nga shërbimi sekret

BOTA / 18 September 2026, 10:12

Lufta/ BE i jep 3.3 miliardë euro Ukrainës për raketa dhe dronë, Von der Leyen: Evropa po bën shumë, edhe të tjerët duhet të rrisin mbështetjen

BOTA / 17 September 2026, 21:13

Arrestohet një ndër njerëzit më të pasur në Hungari dhe aleat i Orbanit

BOTA / 17 September 2026, 20:34

Rusët godasin anijen turke pranë kufirit me Rumaninë, raportohet për viktime

BOTA / 17 September 2026, 19:39

Kthesa politike në Suedi, kryeministri Kristersson jep dorëheqjen pas rezultatit të zgjedhjeve

BOTA / 17 September 2026, 18:40

Kaos në aeroportin e Charleroi, anulohen dhjetëra fluturime në Belgjikë

BOTA / 17 September 2026, 18:03

Trump kërcënon BE-në pas afrimit me Kanadanë: Do të vendos tarifa shumë të rënda

BOTA / 17 September 2026, 17:11

BE kundër përdorimit të rrjeteve sociale nga fëmijët, kufizime të reja për nën 15 vjeç

BOTA / 17 September 2026, 16:44

Mark Carney pranon propozimin që Kanadaja të bëhet anëtare e asociuar e BE-së

BOTA / 17 September 2026, 15:54

Irani i përgjigjet Merzit: Gjermania po paraqet një narrativë "të shtrembëruar" për luftën dhe programin bërthamor

BOTA / 17 September 2026, 14:59

BE: Partneriteti i ri me Kanadanë nuk është një aleancë kundër SHBA!

BOTA / 17 September 2026, 12:06

Paralajmërohen tarifa 500%/ Sanksione më të rrepta të SHBA, Putinit nuk i lejohet më të vizitojë Trumpin

BOTA / 16 September 2026, 22:59

Rriten tensionet Turqi-Greqi/ Ankaraja zhvendos një brigadë me 2 mijë komando përballë Samosit

BOTA / 16 September 2026, 22:36

Rutte: NATO po përballlet me mjedisin më të rrezikshëm dhe kompleks të sigurisë

BOTA / 16 September 2026, 22:12

VIDEO/ Luftime të ashpra në veri të Jemenit, forcat qeveritare avancojnë ndaj Huthëve

tpz.al

TPZ.al është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.



Built & Monetized by **Mediadesk**

AKTUALITET

IDE

NË FOKUS

BALLKAN

BOTA

LIFESTYLE

SPORT

TEJ E KETEJ

BLOG

EMISIONE

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.